



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**  
**Prokuroria Themelore në Prishtinë / Osnovno Tužilastvo u Prištini / Basic**  
**Prosecution Office in Prishtina**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda / Odeljenje za teška krivična dela / Serious Crime**  
**Department**

**PPN-202/17**  
**Më dt.14.11.2017**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, Prokurori i Shtetit Kujtim Munishi, me zyrtares ligjore Vlora Thaqi, pas publikimit të një shkrimi ku ish – kryetari i Gjykatës Kushtetuese, akuzon Kryeprokurorin e Shtetit, për falsifikim të provimit të jurisprudencës, në këtë publikim Enver Hasani, ka paraqitur një raport me titull: MBI DOSJEN E FALSIFIKUAR, DOSJA “02 Broj 152-1-217/90, Priština, 27.02.1991 god.”, QË KA TË BËJË ME PROVIMIN E JURISPRUDENCËS SË ALEKSANDËR LUMEZIT, në pajtim me nenin 82, par.1, nën par.1.1 të KPP-së, merr këtë:

**AKTVENDIM**

HUDHET kallëzimi penal i ushtruar përmes mediave nga ish – kryetari i Gjykatës Kushtetuese, i cili akuzon Kryeprokurorin e Shtetit, për falsifikim të provimit të jurisprudencës, në këtë publikim Enver Hasani, ka paraqitur një raport me titull: MBI DOSJEN E FALSIFIKUAR, DOSJA “02 Broj 152-1-217/90, Priština, 27.02.1991 god.”, QË KA TË BËJË ME PROVIMIN E JURISPRUDENCËS SË ALEKSANDËR LUMEZIT,

**ARSYETIM**

Me të kuptuar këtë fakt, në bazë të vendimit A.nr.208/2015, të datës 17.06.2015, si anëtar i komisionit për përcjelljen ditore të mediave dhe verifikim e pretendimeve të rasteve të supozuara të krimit të organizuar e të korrupsionit, të publikuara përmes mjeteve elektronike dhe të shtypit, në pajtim me nenin 83, paragrafi 1 të KPP-së, kam autorizuar policinë e Kosovës, për mbledhjen e informatave të nevojshme lidhur me dyshimin se është kryer vepra penale Falsifikimi i dokumentit zyrtar, nga neni 434, paragrafi 1 i KPRK-së.

Në të njëjtën kohë kam kërkuar që rasti të monitorohet nga EULEX-i.

EULEX-i ka pranuar kërkesën tonë dhe ka caktuar prokuroren Ewa Korpi, e cila ka monitoruar rastin që nga fillimi.

Policia e Kosovës, ka pranuar autorizimin me dt. 25.10.2017.

Në këtë rast janë caktuar hetuesit policor Avni Namani, me numër të DI-së # 4473, dhe Jeton Menxhiqi, me numër të DI-së #7984, të cilët sipas autorizimit kanë qenë të obliguar që nga Arkivi i Kosovës, të marrin dosjen për dhënien e provimit të Jurisprudencës të Aleksander Lumezit (Kryeprokuror i Shtetit), dosje kjo në të cilën po dyshohet se është bërë falsifikim i dokumentit zyrtar, nga neni 434 par.1 të KPRK-së.

Me datë 25.10.2017 rreth orës 14:00, hetuesit policor kanë shkuar në Arkivin e Kosovës ku fillimisht kanë takuar Ramë Manaj, Kryeshef Ekzekutiv, të cilin e kanë njoftuar se është hapur një hetim dhe se në bazë të autorizimit të Prokurorit të Shtetit, duhet të marrim origjinalin e dosjes së provimit të Judikaturës të Aleksander Lumezit.

Kryeshefi ekzekutiv Ramë Manaj, e ka ftuar Ruzhdi Panxhën, Drejtor i Departamentit të Veprimtarisë Arkivore, të cilin e ka caktuar që t'i asistoj policisë në realizimin e kësaj kërke.

Drejtori i Departamentit të Veprimtarisë Arkivore, Ruzhdi Panxha, na ka ofruar tërë dosjet e provimit të Judikaturës të cilat ndodheshin në Arkivin e Kosovës dhe gjatë kontrollimit të këtyre dosjeve kemi vendosur që të sekuestrojmë në origjinal këto pjesë të dosjeve:

1. Lëndën e procesverbalit të dhënies së provimit të judikaturës, me numër 02/152-1-217/90, të kandidatit Aleksander Lumezi, që përmbante : Mbështjellësin dhe dy fletë me katër faqe.
2. Libër në të cilin në koperinë ishte i vendosur nga Arkivi i Kosovës një fletë e bardhë me mbishkrimin “ Libri mbi lejimin e hyrjes ne provimin e judikatures viti 1990-1992”, mirëpo në koperinë kishte edhe shkrime tjera me lapskimik në gjuhën serbe (Popis akata dhe Prijave za pravosudni ispit).
3. Mbështjellësi i kandidatëve që kanë dhënë provimin e judikatures, i vitit 1991 prej 60 personave.
4. Libër me mbishkrim “Provimi profesional me PSP dhe PLP i viteve 1989-90-1991” me numër nr. 15.
5. Libri në kopje me mbishkrim “Librat e provime të dhëna të Judikaturës i viteve 1986-1993” me nr.11.

Me datë 26.10.2017 rreth orës 09:20, nga Ministria e Drejtësisë, janë marrë librat e dhënies së provimit të judikaturës për periudhat 1986-1992.

Me datë 26.10.2017, në 13:25, në cilësinë e dëshmitarit është intervistuar **Sahit SHALA**, i cili prej vitit prill 1974 deri në vitin 1989, ka punuar në Sekretariatit Krahinor të Judikaturës.

Dëshmitarit i është prezantuar Libri me mbishkrim **“Libri mbi lejimin e hyrjes në provimin e Judikatures”**, duke e pyetur se për çka ka shërbyer ky libër, dëshmitari ka treguar se libri në fjalë ka shërbyer si libër arkivues ku kandidatët kanë dorëzuar kërkesën për provim të judikaturës, duke shtuar se përpos këtij libri kanë qenë edhe dy libra tjera, libri mbi lejimin e provimeve dhe libri mbi dhënien e provimeve. Dëshmitari ka treguar se llaku-korrektori është përdorur kur është bërë ndonjë gabim teknik, mirëpo në procesverbal të provimit të judikatures nuk është përdorur.<sup>1</sup>

Me datë 27/10/2017, për interviste është ftuar dëshmitari **Radislav Dimitrijevic**, i cili ka qenë, Sekretar i Komisionit të Judikaturës në kohën kur Aleksander Lumezi (Kryeprokuror i Shtetit) i është nënshtruar provimit të Judikaturës.

Dëshmitarit i është prezantuar dosja e kandidatit Aleksander Lumezi, dhe është pyetur nëse kjo dosje është punuar nga ai. Me të pa dosjen dëshmitari ka thënë : **“Po këtë dosje e kam plotësuar unë në këtë pjese duke ju referuar mbështjellësit, është nënshkrimi im, emri dhe mbiemri i kandidatit është shkrimi im, ndërsa nën emrin e kandidatit tash po me kujtohet është shkrimi i koleges sime të ndjerë Natalija Kovacevic, me të cilën kam punuar në të njëjtën zyre, ndërsa procesverbali është 99% i imi, në faqen e dytë dhe të tretë, në katër pyetje është shkrimi im dhe nënshkrimi im, ndërsa një faqen e katërt siç shihet kandidati ka mbet në riprovim dhe çdo gjë është ne rregull”**.

Gjithashtu, dëshmitari ka thënë: **“korrektuesi është përdorur, mirëpo jo në çertifikatën e provimit të judikaturës, sepse nëse ka pasur korrektim Kryetari i Komisionit nuk e ka nënshkruar, ndërsa sa i përket regjistrave tjerë ka mundur të ndodhë ndonjëherë, në raste të rralla”**, duke shtuar se: **“më ka ndihmuar në plotësimin e shkresave edhe Natalija Kovacevic, e cila ka punuar me një zyre me mua”**.

Sipas dëshmitarit, deri te përmirësimi i mbështjellësit të kandidatit Aleksander Lumezi, ka ardhur si pasoje e ndonjë gabimi teknik që ka mundur ta ketë bërë kolegja e tij Natalija, e cila deri sa ka plotësuar të dhënat e kandidatit dhe i ka përputhur me procesverbalin, ka vërejtur që ka gabuar.<sup>2</sup>

Me datë 27.10.2017, ish-Sekretari i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, **Sahit Shala**, në një intervistë për ekipin e KTV-së dhe **“Betimi për Drejtësi”**, ka rrëfyer se si në vitin 89 kishte braktisur Komisionin e Jurisprudencës, duke lënë mbrapa të gjithë librat dhe gjithçka tjetër që lidhej me këtë provim në duart e masave të dhunshme.

Me date 30.10.2017 është intervistuar ne cilësi të dëshmitarit prapë **Sahit Shala**, i cili në media kishte deklaruar : **“asnjëherë nuk ka bërë përmirësime të tilla, siç shihen në dosjen e Lumezit”**, sepse një gjë e tillë, sipas tij ka qenë e ndaluar me ligj.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Sahit Shala, dhënë në Polici, me dt.26.10.2017, ora 13:25.

<sup>2</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Radislav Dimitrijevic, dhënë ne Policinë e Kosovës, dt.27.10.2017

<sup>3</sup> <http://www.koha.net/arberi/53645/per-dosjen-e-lumezit-ish-sekretari-i-komisionit-te-jurisprudences-ka-cfare-te-tregoje/>

Dëshmitarin pasi e kemi ballafaquar me disa shkresa të cilat ai vet i kishte nënshkruar kishte pranuar se ka punuar edhe në vitin 1990.

Dëshmitari në polici deklaroi: **“ka ndodhë që kam bërë përmirësime me korrektor me llak në librin e paraqitjes së provimeve, në protokol të Arkivit, në librin për lejimin e hyrje në provim dhe librin e dhënies së provimit, veprime këto që nuk kanë qenë të lejuara me ligj, por ka qenë praktikë”**. Dëshmitarit i është prezantuar libri, ku i njëjti kishte bërë përmirësime në disa raste ( Rasti të kandidatja Biljana Rexhiq dhe Afrim Shefkiu).

Në pyetjen, se pse në media ke thënë që nuk ke bërë përmirësime të tilla ndërsa neve na tregove që ke bërë përmirësime me llak-korrektor?!

Dëshmitari është përgjigjur : **“Kam rënë në lajthim nga pyetjet e gazetarëve”**.<sup>4</sup>

Me datë 31.10.2017, përsëri është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit Radislav Dimitrijevic. Gjatë intervistës i njëjti ka deklaruar: **“procedura e paraqitjes së provimit të judikaturës dhe provimit për gjyqtar për kundërvajtje ka qenë e njëjtë, mirëpo paraqitja e provimit për gjyqtar për kundërvajtje është regjistruar në libër tjetër të veçantë, mbështjellësi i këtij provimi si për jurisprudencë dhe gjyqtar për kundërvajtje ka qenë i njëjtë”**.

Dëshmitarit i është prezantua dosja e Aleksander Lumezit. Dëshmitari me të pa dosjen deklaroi: **“Kjo që po më prezantohet është vetëm provë që i njëjti e ka dorëzuar kërkesën dhe ne e kemi pranuar. Ndërsa tjetri dokument –procesverbali, këtë e kam punuar unë”**. I njëjti i ka identifikuar dy anëtarët e komisionit, Gjorgje Aksiq, profesor i Fakultetit juridik, dhe kryetarin e komisionit, i cili ka qenë Vukashin Jokanoviq . Kandidati si dëshmi që ka paraqitur provimin ka marr një vërtetim që ka dorëzuar kërkesën-dokumentacionin.<sup>5</sup>

Me 31.10.2017 është dëgjuar dëshmitari Zymer (Krasniqi) Tahiri, emri i të cilit ishte fshirë dhe mbi të cilin ishte shkruar emri i kandidatit Aleksandër Lumezit, në dosjen e paraqitjes së provimit të Jurisprudencës.

Dëshmitari ka deklaruar: **“ Unë nuk kam vazhduar ndonjë edukim, por pas përfundimit të praktikës së punës në Gjykatën për Kundërvajtje prej një viti, kam marrë vërtetimin në Gjykatën për Kundërvajtje në Deçan, që dëshmon se e kam kryer praktikën, pastaj kam marrë diplomën e fakultetit juridik, pastaj dokumente tjera që është dashur në atë kohë dhe aq sa më kujtohet ka qenë kah fundi i nëntorit të vitit 1990, kur kam ardhur në Prishtinë dhe kam shkuar për ta paraqitur provimin, atë kohë kanë qenë Organet e Administratës për Judikaturës, përballë Muzeut në Prishtinë.**

**Mua mi ka pranuar këto dokumente një zyrtar serb dhe ma ka lëshuar vërtetimin si dëshmi që e paraqita provimin , ky person me tha që është çdo gjë në rregull dhe do ta dërgojnë ftesën kur mbahen provimet”**.

<sup>4</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Sahit Shala, dhënë në Policinë e Kosovës, dt. 30.10.2017

<sup>5</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Radislav Dimitrijevic, dhënë në Policinë e Kosovës, dt. 31.10.2017

Dëshmitari ka deklaruar se nuk është i sigurtë se cilin provim e ka paraqitur, të Judikaturës apo për Gjyqtar për Kundërvajtje.

Dëshmitarit nuk i kujtohet se ka marrë vërtetim mbi lejim e hyrjes në provim, nuk i kujtohet komisioni, nuk i kujtohen pyetjet dhe **nuk e di nëse e ka dhënë apo jo provimin e judikaturës.**<sup>6</sup>

Me datë 01.11.2017, në cilësi të dëshmitarit është intervistuar Betim Shala, i cili ka deklaruar: “ provimin e Judikaturës e kam përfunduar në vitin 1991, kam mbetur në riprovim në fund të vitit 1990, ndërsa në fillim të vitit 1991, kam përfunduar provimin. Në afatin e parë të mbajtur në vitin 1990, Aleksander Lumezi nuk ka qenë në provim, ndërkaq në afatin e dytë të mbajtur në shkurt të vitit 1991, nuk më kujtohet saktë, por ndoshta edhe ka qenë në këtë afat, është shumë e mundur të ketë qenë.

“Unë personalisht nuk mundem ta di saktë por me kujtohet shumë mirë që në atë kohë në vitin 1991 unë kam punuar në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, ndërkaq Aleksandër Lumezi, ka qenë i punësuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, si praktikant dhe një ditë gjatë pauzës në viti 1991, më ka thirrë Aleksander Lumezi dhe kemi dalur për mëngjes, dhe nuk me kujtohet se kush tjetër ka qenë me ne të dy dhe kemi shkuar në Qebaptoren Sarajeva, me ka thënë Aleksandri, “ **zgjedh çka të duash për mëngjes, se unë po qarosi, pasi që e kam dhënë Provimin e Jurispodencës**”, si detaj që krejt këtë ngjarje e mbaj mend shumë mirë është një fakt, që më ka pasë lënë përshtypje nga ana e tij, është se pasi që zgjedha çka du me hëngër për mëngjes, ai me tha po “**marrim edhe nga një copë djath**” e unë deri atëherë kurrë qebapët me djathë nuk I kam ngrënë” ka thënë dëshmitari Betim Shala.

Në pyetjen: a i keni dhëne ju leje qoftë verbale apo me shkrim Enver Hasanit, që ai ta shikoj ndonjë dosje tuaj në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

**Dëshmitari u përgjigj:** “Enver Hasani, asnjëherë nuk ka kërkuar leje nga unë dhe asnjëherë nuk kemi diskutuar në lidhje me lejen e tillë. Unë nuk kam pas asnjë interes juridik apo personal që së pari vet të kërkoj dosjen, e lere më që të kërkoj nga ai, mendoj në Enver Hasanin, që të hulumton dosjen e time nga provimi i Judikaturës. Mirëpo edhe nëse kisha pas ndonjë interes do ta kisha bërë vetë këtë hulumtim, apo do ta kisha angazhuar ndonjë shok – avokat, e asesi Enver Hasanin”.

Me datë 01.11.2017, i është bërë një kërkesë zyrës së UNMIK-ut, për ta siguruar dosjen e kandidatit Aleksander LUMEZI, të cilit ju ka bërë verifikimin nga Njësia për Vlerësim Profesional. Nga të njëjtit nuk kemi pranur dosjen e kërkuar.

Me datë 02.11.2017, nga Arkivi i Kosovës është gjetur lista e të gjithë kandidatëve që ju kanë nënshtruar provimit dhe riprovimit me date 23/24 prill 1991, ku në mesin e kandidatëve figuron edhe emri i Aleksander Lumezit, është siguruar lista e antarëve të komisionit për dhënien e provimit të Judikaturës dhe janë marrë në kopje dosjet e dy kandidatëve: Vasic Branislava dhe Ciric Cvetanka, me qëllim të krahasimit me dosjen e A. Lumezit.

---

<sup>6</sup> Lexo deklaratën e Zymer Krasniqit dhënë ne Policinë e Kosovës me dt.31.10.2017.



Me datë 02.11.2017, në Gjykatën e Apelit, kemi siguruar dosjen e Aleksander Lumezit, me sa vijon:

- Kopje një faqe e librit amzë
- Dosja e praktikantit Aleksander Lumezit, e cila përmban: aktvendime të pushimeve të lejuara, për lidhjen e marrëdhënies së punës, për pagesë, kërkesë për pagesë të pushimit para hyrjes në provim të Judikaturës, aprovim i pushimit, vërtetim mbi çregjistrimin e sigurimit, aktvendim mbi të ardhurat personale, Lutje për punësim, aktvendim për kryerjen e praktikës dhe aktvendim për pranim në punë si praktikant.

#### **Me datë 02.11.2017 është intervistuar dëshmitari Riza Smaka, i cili ka deklaruar:**

“Në vitin 2000, kam qenë Koordinator i Këshillit për Rekrutimin e kandidatve për prokurorë dhe gjykatës, i cili ka qenë në kuadër të UNMIK-ut dhe jam emëruar si koordinator nga Bernard Kushner.

Unë kisha për detyrë përcaktimin e kritereve për konkursin publik për kandidatët për prokurorë dhe gjykatës si dhe realizimi i konkursit duke e përfshirë propozimin e kandidatëve dhe kandidateve. Emërimin e ka bërë dr. Bernard Kushner. Me kujtohet se sipas propozimit tim këshilli i ka pas përcaktuar anëtarët e vet për intervistimet nëpër qytete të Kosovës në përshtatje me afinitetet e intervistuesve.

Për Prishtinë dhe rajonin e Prishtinës, këshilli e ka pas emëruar Adil Fetahun, bashkë me dy anëtarë të jashtëm, një nga Finlanda tjetri nga SHBA-ja. Për provimin e Aleksander Lumezit, plotësisht është i informuar dhe ka shënime zyrtare zotëri Adil Fetahu, ngase ai me dy kolegët e tjerë e ka pas bërë intervistimin gojor të Aleksander Lumezi. Mua sa më kujtohet zotëri Aleksander Lumezi në atë etape nuk e ka pasur Çertifikatën e Judikaturës. Megjithatë, **unë shprehi dyshime** përkitazi kësaj rrethane ngase ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk i kam shënimet zyrtare, as që i kam pas marrë me veti. Rrethana se Aleksander Lumezi ka qenë emëruar Zëvendës Prokuror Komunal në Prishtinë nga dr. Kushner, **më bën edhe me tepër të luhatshtëm përkitazi me faktin se zotëri Lumezi në atë etapë e ka pas apo nuk e ka pas çertifikatën e Judikaturës.** Në këtë kontekst theksoj se relacionet personale me zotëri Aleksander Lumezi kurdoherë i kam pas normale dhe njerëzore.

Unë në mendjen time mjegullisht me kujtohet nga puna e komisionit se Aleksander Lumezi nuk e posedon Provimin e Judikaturës, por nuk jam i sigurtë për këtë.

Unë e kam thirrë sot Adilin, sepse nuk kam qenë i sigurt nëse Aleksander Lumezi, e ka të kryer Provimin e Judikaturës dhe e kam thirrë që të marrë informatat më të sigurta për çështjen.

Në atë kohë ka pasur shumë kandidat që nuk e kanë pasur provimin e Judikaturës, si pasoj e mosmbajtjes së provimit për 10 vite. Këta kandidat nuk i kemi pranur”.

Me datë 03.11.2017, kemi shkuar në Arkivin Komunal në Prishtinë, për të verifikuar nëse posedojnë ndonjë dosje të ish Sekretariatit Krahinor, të cilët na kanë thënë se nuk posedojmë diçka të tillë sepse çdo gjë që ka qenë krahinor ka shkuar në arkivin qendror.

Me datë 03.11.2017, kemi dorëzuar kërkesë në OSBE, ku kemi kërkuar dosjet për rekrutitim e prokurorëve dhe gjyqtarëve në periudhën 1999-2000, mirëpo nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Me datë 03.11.2017, kemi dorëzuar një kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë-Departamentin për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare, duke kërkuar që të intervistojnë në cilësinë e dëshmitarëve dëshmitarët Vukashin Jokanovic, Mirko Perunovic, Djordje Aksic dhe Miladin Kostic, të cilët jetojnë në Serbi.

Mirëpo, këtë kërkesë pas datës 08.11.2017, e kemi pa të panevojshme, sepse vullnetarisht në Kosovë ka ardhur për të dëshmuar prof. Miladin Kostic, dhe nga anëtari Djordje Aksic (anëtar i komisionit), kemi pranuar një akt noterial përmes së cilit dëshmitari ka deklaruar sa i përket provimit të judikaturës, për datat 24-26 Prill 1991.

Me datë 06.11.2017, kemi qenë në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, për të kërkuar nëse gjendej ndonjë dokument me rëndësi për rastin, kërkimet janë bërë edhe në depon e Arkivit, mirëpo nuk kemi gjetur ndonjë dokument relevant.

**Me datë 06.11.2017, është intervistuar Sahit Shala, në cilësi të dëshmitarit, i cili ka deklaruar:**

“Kam bërë përmirësime, por as unë nuk kam shënuar në katrorin ku shënohen vërejtjet, edhe pse është dashur të shkruhen. Sa i përket Sekretarit Krahinor për Judikaturë, Djordje Aksic, i cili në dosjen e Lumezit ka nënshkrim si anëtar i komisionit, kjo nuk ka qenë praktike gjatë punës time dhe mendoj që është konflikt i interesit. Për paraqitjen e provimit të Judikaturës nuk ka pasur afat të caktuar. Ne kemi përpiluar lista të kandidatëve të cilët i nënshtrohen provimit, mirëpo këto lista nuk i kemi ruajtur, pasi që nuk kanë pasë rëndësi të veçantë”.

Sa i përket pyetjes se a ka mundur kandidati që ta paraqes provimin para se ta plotëson kushtin prej një viti të punës praktike.

**Dëshmitari u përgjigj: “Ka mundur, nëse ky kandidat para hyrjes në provim, përkatësisht para vendimit për lejimin e hyrjes në provim, ka sjellë dëshmin se e ka kryer praktikën prej një viti dhe kështu ai i ka plotësuar kushtin prej një viti të praktikës, para nënshtimit të provimit të Judikaturës”.**

Dëshmitarit i është prezantuar dosja me procesverbalin e dhënies së provimit të Judikaturës, me numër **02/152-1-217/90**, e kandidatit Aleksander Lumezi, dosje kjo e cila përmbante mbështjellësin dhe dy fletë me katër faqe, duke e pyetur se çka mendon për këtë dosje.

**Dëshmitari u përgjigj:** “mungojnë punimet me shkrim, dokumentet për lejimin e provimit (vërtetimi mbi përvojën e punës, kopja e vërtetuar e diplomës, aktvendimi mbi lejimin e provimit) ndërsa sa i përket tjerave mendoj se është gjithçka ne rregull.”<sup>7</sup>

**Me datë 06.11.2017 është intervistuar Enver Hasani, në cilësi të dëshmitarit, i cili ka deklaruar: “qëndrojmbrapa deklaratës se dhënë në media me titull “MBI DOSJEN E FALSIFIKUAR, DOSJA “02 Broj 152-1-217/90, Pristina, 27.02.1991 god.” ,QE KA TË BËJË ME PROVIMIN E JURISPRUDENCËS SË ALEKSANDËR LUMEZIT”, raport ky i cili ekziston në gjuhën shqipe dhe angleze , të cilin ia kam dërguar shteteve të QUINTIT dhe gjitha mediave.”<sup>8</sup>**

<sup>7</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Sahit Shala, dhënë në Policinë e Kosovës, dt.06.11.2017

<sup>8</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Enver Hasani, dhënë në Policinë e Kosovës, dt.06.11.2017

**Me datë 07.11.2017, është intervistuar dëshmitari Aleksander LUMEZI, i cili ka deklaruar:**

“Provimin e judikatures e kam paraqitur diku në fund të vitit 1990, nuk më kujtohet se cili person ka qenë por më kujtohet se e kam dorëzuar në sekretariatit Krahinor të atëhershëm për Judikaturë dhe Administratë. Në mesin e dokumenteve, aty kam paraqitë vërtetimin që e kam stazhin e praktikantit, vërtetimin që nuk jam nën hetime, kopje të diplomës së fakultetit, me sa më duket këto kanë qenë krejt dhe nuk me kujtohet diçka tjetër sepse ka kaluar një kohë e gjatë. Me aq sa më kujtohet diku në shkurt të vitit 1991 kam hyrë në provim për herë të parë dhe fillimisht kemi pasë provimin me shkrim nga e drejta penale dhe civile, ka qenë kusht për ti dhënë këto dy provime për të vazhduar me provimin me gojë, pastaj provimin me gojë, pas një jave me 25 dhe me 26 shkurt 1991 është mbajtur provimi me gojë.

Unë kam kërkuar publikisht por edhe nga Kryeprokurori i EULEX-it, për shkak të shmangies të panshmerisë ta marrin këtë lëndë, në bazë të nenit 7A, të ligjit për vazhdimin e Misionit të EULEX-it në Kosovë, apo që të njëjtën lëndë ta monitoroj EULEX-i.<sup>9</sup>

**Me datë 07.11.2017, i është bërë kërkesë përmes emaili-t Timothy J. Baland-it, që ka punuar në Njësinë e Vlerësimit Profesional për Gjyqtar dhe Prokuror, në vitin 2009, për tu përgjigjur në disa pyetje specifike lidhur me vlerësimin e kandidatëve.**

Me datë 08.11.2017, Timothy J. Baland është përgjigjur përmes imejlit dhe ka thënë:

“Si përgjigje ndaj pyetjes tuaj me email të datës 7 nëntor 2107, dëshiroj t’ju informoj se çdo diplomë provimi është verifikuar nga departamenti përkatës brenda Ministrisë së Drejtësisë nga juristet në Njësinë e Vlerësimit Profesional të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial.

Në mënyrë të veçantë, stafi i Njësisë së Vlerësimit Profesional, personalisht ka kontrolluar librat dhe regjistrimet relevante, duke përfshirë regjistrin në pajtim dhe mirëmbajtur nga Ministria e Drejtësisë, e atyre që kishin kaluar provimin e jurisprudencës.

Kjo punë është bërë në pajtim me rregullat e brendshme të punës që kanë qeverisur punën e Njësisë së Vlerësimit Profesional. Për informacionin tuaj, unë kam përfshirë një ekstrakt nga ato Rregulla me këtë përgjigje në kërkesën tuaj. Kam përfshirë gjithashtu një ekstrakt nga Raporti Përfundimtar mbi punën e Komisionit në lidhje me detyrat e Njësisë së Vlerësimit Profesional.

Duke pasur parasysh kujdesin me të cilin anëtarët e Njësisë së Vlerësimit Profesional ndërmorën dhe kryenin përgjegjësitë e tyre, është shumë e vështirë për mua të besoj se dikush do të kishte qenë në gjendje të falsifikonte ekzistencën ose vlefshmërinë e diplomës së provimit të jurisprudencës që ishte paraqitur nga një kandidat në lidhje me aplikimin e tij ose të saj.

---

<sup>9</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Aleksander Lumezi, dhënë në Polici, me dt.07.11.2017.



Megjithëse nuk jam i sigurt për këtë, është e mundur që njësia e verifikimit brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës të ketë disa arkiva nga puna e bërë nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial”.

**Është siguruar deklarata noteriale e anëtarit të Komisionit të Judikaturës Djorde Aksic, në kohën kur Aleksander Lumezi i është nënshtruar provimit të judikaturës; deklarata thotë:**

Me kërkesë të Aleksander LUMEZI-it nga Prishtina, me pergjegjësi të plotë jap këtë deklaratë:

Certifikata mbi kalimin e provimit të Judikaturës me nr.02 br.152-1-1217/90 nga viti 06.05.1991 e cila më është dhënë në shikim, në të cilën thuhet se Aleksander LUMEZI nga Prishtina me datën 25.04.1991 e ka dhënë provimin e Judikaturës unë e kam nënshkruar.

Në bazë të raportit të komisionit për dhënien e provimit të Judikaturës, Sekretari Krahinor për Judikaturë ka qenë i autorizuar për ta nënshkruar Certifikatën për dhënien e provimit të Judikaturës.<sup>10</sup>

**Me datë 07/11/2017 kemi intervistuar Radislav Dimitrijevic-in , sa i përket dilemave në data( 24-26 Prill 1991) dhe pjesëmarrjes së Sekretarit Krahinor për Jurisprudencë Djorgje Aksic , i cili njëherit ka qenë edhe anëtar i komisionit, dëshmitari ka deklaruar:**

“Sa i përket datave të riprovimit 24-26 viti 1991, gjithçka është në rregull.

Ndërsa, sa i përket faqes së riprovimit (faqe 4) te pjesa ku kandidati i nënshtrohet riprovimit, në formular shkruan Gradjansko pravo dhe Krivicno pravo, ka qenë gabimi im se është dashtë që ti bie vijë ku shkruan e drejta penale dhe në vend të saj të shkruaj e drejta ekonomike, dua të shtoj se të gjithë formularët kanë qenë të njëjtë dhe shumica e kandidatëve kanë mbetë në riprovim nga lënda penale ose civile”.

Çertifikata me datën 25/04/1991 është lëshuar duke u bazuar në të dhënat e Librit për dhënien e provimit të Judikaturës, ndërsa data 26.04.1991, që figuron në Procesverbal mund të jetë gabim teknik i imi, sepse është e logjikshme se provimi ka zgjatë më shumë se një ditë sepse kemi pasur shumë kandidat dhe për këtë arsye unë kam mundur ta regjistroj datën 26.04.1991, e kandidati i është nënshtruar dhe ka dhënë provimin me 25.04.1991.

Sa i përket Djorde Aksic-it, ai ka pasur autorizimin të nënshkruaj procesverbalet edhe pse ka qenë epror po të njëjtën kohë, ka qenë edhe anëtar i komisionit.

Djorde Aksic ka marrë pjesë në provim të Judikaturës dhe i ka pyetur kandidatët në të drejtën penale”.

---

<sup>10</sup> Lexo deklaratën e Djorgje Aksic-it, dhënë para noterit në Beograd, dt.01.11.2017.

**Me datën 08.11.2017, është intervistuar Miladin Kostic, anëtar i Komisionit të Judikaturës, në vitin 1990-91, i cili ka deklaruar:**

“Në vitin 1990-1991 , kam qenë profesor në Fakultetin Juridik në Prishtinë , e kam pasë edhe detyrën e sekretarit të Fakultetit, gjithashtu kam qenë anëtar i Komisionit për dhënien e Provimit të Judikaturës, në provimin e Judikaturës kanë qenë Vukasin Jokanovic, të drejtën Kushtetuese dhe Organizimin e Gjykatave, Mirko Perunovic ka pyet te drejtën Ekonomike, i cili ka vdekur diku para 6 -8 muaj, Djorde Aksic ka pyet të drejtën Penale, Ljubomir Popovic ka pyete te drejtën Civile, ndërsa unë kam pyet të drejtën Administrative dhe te drejtën e Punës, sekretar i komisionit ka qenë Radislav Dimitrijevic.

Anëtarë i Provimit të Judikatures kam qenë nga 1991 deri 1993 ose 1994, aq sa me kujtohet.”

Dëshmitarit i është prezantuar dosja e provimit të Judikaturës së kandidatit Aleksander LUMEZI, dhe pyetet nëse është në gjendje për ta identifikuar ndonjë shkrimi apo nënshkrimin nëse është i tij.

**Dëshmitari përgjigjet:** “Po unë jam në gjendje për ta njohur dhe identifikuar shkrimin tim, i cili është në pikën 5, ku unë i kam shkruar me dorën time dy pyetje dhe në pikën e 6, unë i kam shkruar me dorën time dy pyetje, gjithashtu nënshkrimi në faqen e tretë dhe në faqen e 4 është nënshkrimi im. Kandidati herën e parë ka mbetë në provim dhe në riprovim e ka kaluar provimin e Judikaturës, ku unë e kam nënshkruar këtë procesverbal dhe kjo është e pakontestuar që kandidati e ka dhënë provimin e Judikaturës.

Procesverbali i provimit është i pakontestueshme, këtë po e shoh dhe nuk ka asnjë dileme sa i përket vërtetësisë së tij dhe çdo gjë është në rregull, Mbështjellësi nuk është i rëndësishëm, sepse pjesa kryesore procesverbali është i pakontestueshëm dhe çdo gjë është në rregull.

Mbështjellësi nuk ka rëndësi, sepse këtë e ka punuar sekretari dhe ai ka mundur të bëj ndonjë gabim teknik, **pjesa me rëndësi edhe një herë po e cekim është procesverbali ku nënshkruhen të gjithë anëtarët e komisionit dhe nuk ka asnjë ndërhyrje ose përmirësim dhe është shkruar dhe nënshkruar nga unë dhe anëtarët tjerë të komisionit.**

Në këtë procesverbal është nënshkrimi i Mirko Perunovic, Ljubomir Popovic, Djorde Aksic dhe Vukasin Jokanovic dhe siç shihet edhe në faqen 3 dhe 4 janë nënshkrime identike pasi që janë bërë në kohë të ndryshme”.

Se a ka pasur të drejtë Djorde Aksic që të jetë edhe Sekretar Krahinor për Judikaturë edhe anëtar i komisionit për dhënien e provimit te Judikaturës, dëshmitari thotë: **“Djordje nuk e ka emëruar veten si anëtar, por këtë emërim e ka bërë Sekretariati Republikan dhe çdo gjë ka qenë në rregull”.**

Sa i përket datave 24 dhe 26 Prill, 1991, dëshmitari thotë: **“në procesverbal në fillim të faqen e 4 janë të evidentuara datat 24 dhe 26 prill, kur kandidati e ka kryer provimin me shkrim nga e drejta civile, ndërsa provimin me gojë ka mundur me dhëne me datë 25 apo 26, gjë që nuk është e rëndësishme, meqenëse kandidati e ka dhënë provimin e judikatures që vërtetohet edhe me nënshkrimet e anëtarve dhe kryetarit të komisionit ”.**

**Me datë 09.11.2017, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar Adil Fetahu, i cili ka deklaruar:**

Nga shtatori 1999 deri dhjetor 2000 kam qenë anëtare i komisionit gjyqësor dhe prokurorial të UNMIK-ut, pastaj kam qenë i papunë deri ne vitin 2003, kur jam punësuar në institutin privat për ekonomi, ku kam punuar deri në nëntor 2004, dhe prej asaj date jam pensionuar dhe nuk kam punuar.

Detyrë e jona ka qenë që të mbledhim dokumentet e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar për gjyqtarë dhe prokurorë në tërë Kosovën. Konkurset i ka shpallë OSCE-ja, dhe i ka mbledhë dokumentet nga aplikantët, dhe na i kanë dorëzuar neve-komisionit për ti verifikuar dokumentacionet dhe aplikacionet të cilat i kanë dorëzuar kandidatët, komisioni me ka caktuar mua, Anti Ruocsavalin nga Finlanda dhe Pamela Fahei, e cila ka qenë nga SHBA-ja, në nën komisionin për regjionin e Prishtinës, ku detyrë e imja ishte që ti kontrolloj aplikacionet e aplikantëve, ta bëj regjistrin dhe të ja paraqes komisionit se çka kanë dorëzuar aplikantët.

Me këtë rast unë me datat 8,9,13,20 dhe 21 mars të vitit 2000, i kam lexuar dhe kontrolluar detajisht aplikacionet e 305 kandidatëve të cilët kanë konkurruar për gjykatës, prokurorë apo Gjykatës për Kundërvajtje (kjo është e evidentuar në raportin me titull vërejtje hyrëse), me këtë rast unë kam përpiluar një raport për komision në të cilin i kam listuar të gjithë kandidatët sipas gjetjeve të mia në aplikacion dhe dokumente. Pastaj, unë këtë raport ja kam dorëzuar komisionit i cili i ka caktuar terminët për intervistimin e kandidatëve.

Pastaj, nënkomisioni i ka intervistuar kandidatët në lokalet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, pas intervistimit, nënkomisioni e ka përpiluar një raport , listë lidhur me kandidatët të cilët kemi menduar se i plotësojnë kriteret dhe kushtet e konkursit dhe këtë listë ja kemi dorëzuar komisionit i cili pastaj i ka përpiluar listën dhe i ka propozuar

Bernard Kouchnerit kandidatët për emërim në pozitat e gjyqtarit, prokurorit dhe gjyqtarit për kundërvajtje.

Për të qenë më i saktë në këtë pyetje, kësaj deklarate ia bashkangjes një kopje të procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtur të hënën me 04 shtator 2000, i cili i përmban të gjithë emrat e anëtarve të komisionit.

**Në pyetjen se pse disa kandidatë** që kanë punuar si Gjykatës Komunal, Gjykatës në Gjykatën e Qarkut, Gjykatës në Gjykatën Supreme dhe Avokat, më shumë se 10 apo 20 vite, por që nuk e kanë evidentuar se kanë të dhënë provimin e Judikaturës.

**Dëshmitari u përgjigj:** “Kjo nënkupton që ai kandidat ose nuk e ka evidentuar në aplikacion ose nuk ia ka bashkangjitur kopjen e certifikatës së provimit të Judikaturës.

**Në pyetjen:** A do të thotë kjo që kandidati nuk e ka pasë të kryer provimin e Judikaturës?  
**Dëshmitari u përgjigj:** “Jo nuk do të thotë asses, sepse ai ka punuar një kohë të gjatë si gjyqtarë dhe nuk ka mundur për të punuar pa e pasë provimin e kryer, këtë e kam thënë edhe në fletën e parë të raportit që ju e keni ku thuhet, Vetëm 88 kandidatë e kishin shkruar në aplikacion se e kanë të dhënë provimin e jurisprudencës ose atë profesional apo që të dyja rrallë ndonjë kandidat ia ka bashkangjitur aplikacionit certifikatën e provimit të dhëne mirëpo është një numër i madh i kandidatëve të cilët kanë punuar kohë të gjatë në detyrën e gjykatësit apo prokurorit, që do të thotë se ata e kanë provimin e dhënë, por që në aplikacion nuk e kanë shkruar për shkak se në rubrikat e aplikacionit nuk ekziston kërkesë recidive për këtë, prandaj në intervista duhet të ftohen të gjithë ata kandidatë për të cilët nuk dihet me siguri se a e kanë provimin të dhëne apo jo”.

**Në pyetjen:** Në medime publike para gazetarëve ju keni deklaruar se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës. Ke thënë se personalisht i ke mbajtur shënimet dhe e ke pyetur Lumezin, i cili ka deklaruar se nuk e ka provimin e jurisprudencës.

**Dëshmitari u përgjigj:** “Unë nuk kam deklaruar kështu, por kam deklaruar se ai me rastin e dorëzimit të aplikacionit dhe dokumenteve të bashkangjitura nuk e ka cekë në aplikacion se e ka kryer dhe se nuk ia ka bashkëngjitur kopjen e certifikatës aplikacionit, por kjo nuk nënkupton se ai nuk e ka sjellë gjate intervistës, sikurse edhe kandidatët tjerë e kanë sjellë gjatë intervistës”.<sup>11</sup>

Me dt. 13.11.2017, nga Arkivi ni Kosovës kemi arritur të gjejmë librin e paraqitjes së provimit për gjyqtarët për kundërvajtje, me numër protokoli, 02/152-2 për vitin 1989/90. Në këtë libër nën numrin rendor 5, shihet kërkesa e kandidatit Zymer Krasniqi, që ka paraqitur kërkesën për dhënie të provimit për GJYQTAR PËR KUNDËRVAJTJE.

Poashtu, është siguruar shkresa e lëshuar nga ish Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Deçan, e datës 12.10.1990 me numër protokoli, 358/90, e nga ku shihet se Zymer Krasniqi ka punuar në këtë gjykatë si praktikant dhe se vërtetimin në fjalë e ka kërkuar me qëllim që ti shërbejë për paraqitjen e provimit PËR GJYQTAR PËR KUNDËRVAJTJE. Nga ky fakt rezulton se edhe është bërë gabimi në evidentim, ngase kërkesa për dhënie të provimit për GJYQTAR PËR KUNDËRVAJTJE është evidentuar NË LIBRIN PËR DHËNIE TË PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS.

Duket se ky gabim është vërejtur me datë 11.01.1991 nga ana e referentit që ka bërë përmiresimin me korrektor, ashtu që z. Krasniqi e kanë regjistruar në mënyrë të drejtë në librin e paraqitjes së provimit për gjyqtar për kundërvajtje me numrin rendor 5 e cila mban datën 11.01.1991 ndërsa në vend të tij në librin për dhënie të provimit të judikaturës kanë regjistruar atëkohë kandidatin Aleksandër Lumezi.

---

<sup>11</sup> Lexo deklaratën e dëshmitarit Adil Fetahu, dhënë në Polici me dt.09.11.2017

Përdorimi i korrektorit në librat e Judikaturës ka qenë jo i rrallë. Vlen të përmendet fakti se në të njëjtën faqe të librit të paraqitjes së provimit të judikaturës ku gjendet emri i Aleksander Lumezit, janë bërë edhe dy korrektime me llak të bardhë: numri rendor 213, emri i kandidates Milena Vuckovic dhe numri rendor 220, kandidati Hasan Kërveshi.<sup>12</sup>

Andaj, pretendimet se dosja e Aleksander Lumezit (Kryeprokuror i Shtetit), është e manipuluar dhe falsifikuar, nuk qëndrojnë, e këtë më së miri e vërtetojnë këto fakte:

1. Deklaratat e dëshmitarit z. Rade Dimitrijevic, i cili ka qenë Sekretar i Komisionit të Judikaturës në kohën kur Aleksander Lumezi ka hyrë në provimin e Judikaturës, dosjen e të cilit e ka plotësuar vet ai ashtu siç ka deklaruar. Ai në deklaratën e dhënë ka deklaruar se proseverbalin e provimit të judikaturës e ka plotësuar vet, ka identifikuar shkrimin e vet, pastaj ka deklaruar se edhe shkrimi në mbështjellës i emrit Aleksander Lumezi është i tij, ndërsa sa i përket pjesës ku është shënuar “Zahtev za polaganje pravosudnog ispita” e shkruar në alfabetin cirilik, është shkrimi i bashkëpunëtores në zyrën e tij Natalia Kovacevic, duke shtuar se mbështjellësi nuk është shumë i rëndësishëm, me rëndësi sipas tij është procesverbali i provimit. Sipas dëshmitarit gjithçka është në rregull me provimin dhe me dosjen. Ndërsa, sa i përket pretendimeve se data e dhënies së provimit është 26 Prill 1991, ndërsa në certifikaten e provimit kemi datën 25 Prill 1991, kjo është sqaruar nga dëshmitari i cili ka thënë se kandidati i është nënshtruar provimit me dt.24 Prill 1991 dhe shpesh ju ka ndodhur që provimi të vazhdoj edhe pas mesnate, që i bie 25 Prill 1991, dhe për këtë arsye edhe data në Çertifikatë dhe në Libër të dhënies së provimit është e saktë. Ndërsa, pse është shkruar data 26 në proces verbal, këtë fakt e ka sqaruar dëshmitari Radislav Dimitrijevic, i cili ka thënë se “ kjo ka mundur të jetë gabim i imi teknik dhe jo diçka tjetër”.
2. Deklaratë bindëse se dosja e Aleksander Lumezit nuk është e manipuluar dhe falsifikuar, është deklarata e dëshmitarit z. Miladin Kostic, anëtar i komisionit të Judikaturës, njëherit edhe profesor nga e drejta Administrative dhe e drejta e Punës, cili ka ardhur nga Serbia dhe ka deklaruar se në dosjen e provimit të Lumezit nuk ka asgjë diskutabile, çdo gjë është në rregull. “Mbështjellësi nuk ka rëndësi, sepse këtë e ka punuar sekretari dhe ai ka mundur të bëj ndonjë gabim teknik, **pjesa me rëndësi edhe një herë po e ceki është procesverbali ku nënshkruhen të gjithë anëtarët e komisionit dhe nuk ka asnjë ndërhyrje ose përmirësim dhe është shkruar dhe nënshkruar nga unë dhe anëtarët tjerë të komisionit**”.
3. PROCESVERBALI I DATËS 23 dhe 24.04.1991  
Në këtë proceverbal nën numrin rendor 12, mund të shihet qartë se Aleksander Lumezi, është njëri nga kandidatët që ka mbetur në riprovim.

---

<sup>12</sup> Shiko faqen e librit për paraqitjen e provimit e Judikaturës, viti 1990.



4. LIBRI I DHËNIES SË PROVIMIT TË JUDIKATURËS  
Në këtë libër shihet qartë se kandidati Aleksandër Lumezi, ka kryer provimin e Judikaturës, numri rendor 30, numri i lëndës 152-1-217/90, dt.06.05.1991, data e dhënies së provimit 25.04.1991.
5. ÇERTIFIKATA E DHËNIES SË PROVIMIT TË JUDIKATURËS E ALEKSANDËR LUMEZIT, DT.06.05.1991.
6. MBËSHTJELLËSI I DOSJEVE PËR KANDIDATËT QË KANË DHËNË PROVIMIN E JUDIKATURËS  
  
Në këtë mbështjellës shihet një mbishkrim “Sekretariati i Judikaturës dhe Administratës të Kosovës 1991, kanë dhënë provimin e judikaturës”  
Nga kjo listë e cila ka 60 kandidatë, nën numrin rendor 2 është Alekander Lumezi.
7. LIBRI I PARAQITJES SË PROVIMIT PROFESIONAL ME PSP DHE PLP, I VITEVE 1989-90-1991, me të cilin vërtetohet se zyrtari i shkrimores gabimisht e ka evidentuar në këtë libër Aleksander Lumezin, me numër rendor 1 date 09.01.1991.
8. Se kandidati Aleksander Lumezi, i ka plotësuar të gjitha kushtet për të ju nënshtruar provimit, dëshmohet me procesverbalin e provimit të Judikaturës faqja e parë ku thuhet: “ **Nënshtrimi në provim është lejuar me aktvendimin e këtij sekretariati nr. 152-1-217 datës 11.02.1991**”.
9. Nga 19 kandidatet të cilët i janë nënshtruar riprovimit me datë 24-26 Prill 1991, kemi vërtetuar se 11 prej tyre, ku përfshihet edhe kandidati Aleksander Lumezi, në Çertifikatën e dhënies së provimit të Judikaturës kanë datën **25.04.1991**.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, provave materiale , dëgjimit të dëshmitarëve dhe vlerësimit të të gjitha provave të cilat janë pjesë përbërëse e këtij hetimi, vihet në përfundim se në rastin konkret Dosja e cila po dyshohej se mund të jetë e manipuluar dhe falsifikuar, me asnjë provë nuk është vërtetuar një gjë e tillë.

Hetimet janë kryer nën monitorimin e Prokurores së EULEX-it Ewa Kopri, e cila ka qenë e informuar ose prezente në çdo veprim hetimor të policisë dhe prokurorisë.

Në pajtim me autorizimet e përgjithshme të prokurorit të shtetit, sipas nenit 82 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**PROKURORI I SHTESTIT**

**KUJTIM MUNISHI**

